



Federata Aeronautike e Kosovës

RREGULLORJA PËR HARTIMIN E RANGLISTËS SË FEDERATËS AERONAUTIKE TË KOSOVËS, DISCIPLINA PARAGLLAJDIZËM

Kryesia e Federatës Aeronautike të Kosovës në mbledhjen e vet të mbajtur më 04.03.2015, aprovoi:

RREGULLOREN 02/2015

HARTIMI I RANGLISTËS SË FEDERATËS AERONAUTIKE TË KOSOVËS, DISCIPLINA PARAGLLAJDIZËM

Neni 1.

Me këtë rregullore përcaktohet ranglista e pilotëve të cilët veprojnë në kuadër të klubeve të cilat janë të anëtarësuar në Federatën Aeronautike të Kosovës (më tutje FAK).

Rregullorja parasheh që në ranglistë të përfshihen vetëm pilotët e licensuar nga autoritetet e Republikës së Kosovës.

Në kuadër të paragllajdizimit, në FAK zhvillohen dy disciplina të këtij sporti, garat për precizion dhe garat në distancë (cross-country), prandaj edhe kjo rregullore parasheh që të formohen dy ranglista, një për secilën disiplinë.

Neni 2.

Me këtë rregullore përcaktohet mënyra e vlerësimit të rezultateve të pilotëve në garat e organizuara nga FAK në disiplinat përkatëse si dhe pikësimi në bazë të parametrave të tjera të përcaktuara me këtë rregullore.

Neni 3.

Në fillim të çdo sezoni garues komisioni i paragllajdizimit në kuadër të FAK përcakton garat të cilat kualifikohen për pikëzim të garuesve në ranglistë.



Federata Aeronautike e Kosovës

Neni 4.

Ranglista e FAK azhurnohet pas çdo gare të kualifikuar për piksim, ashtu që tabela përfundimtare e ranglistës së FAK përmbanë rezultatet e 6 garave të fundit të disiplinës përkatëse.

Neni 5.

Ranglista e FAK përpilohet duke e bazuar në këto kritere:

5.1 - Pjesëmarrja në gara të kualifikuara për pikëzim (garat që definoohen sipas nenit 3). Çdo pilot që është pjesëmarrës në këto gara vlerësohet me 1 (një) pikë, për garën në të cilën ka marrë pjesë. Me pjesëmarrje në garë nënkuptohet që garuesi ka bërë fluturim në kuadër të garës së organizuar dhe i njëjti është i shënuar si pjesëmarrës aktiv nga gjyqtarët e garës.

5.2 - Vlerësimi i rezultateve të pilotëve në garë. Në përfundim të secilës garë, komisioni për paraglajdzëm në kuadër të FAK, nxjerrë rezultatet e pilotëve Kosovar pjesëmarrës në garën përkatëse dhe bënë pikëzimin e tyre, si dhe renditjen në ranglistë duke u bazuar në këtë tabelë:

- Vendi i pare: 5 pikë
- Vendi i dytë: 4 pikë
- Vendi i tretë: 3 pikë
- Vendi i katërt: 2 pikë
- Vendi i pestë: 1 pikë

5.3 - Vlerësimi i aktivitetit të përgjithshëm të pilotit. Aktiviteti i pilotit konsiderohet çdo fluturim i pilotit në çfarëdo qoftë kohëzgjatje i cili është i regjistruar në pajisje me GPS, si dhe i vendosur në web portalin publik për regjistrim të fluturimeve tëlira Leonardo (<http://www.paraglidingforum.com/leonardo>).

Vlerësimi i aktivitetit të përgjithshëm të pilotit (orëve të fluturimit) bëhet duke u bazuar në tabelën e mëposhtme:

- 1 deri 10 orë fluturimi brenda vitit: 1 pikë
- 11 deri 20 orë fluturimi brenda vitit: 3 pikë
- 21 deri 30 orë fluturimi brenda vitit: 5 pikë



Federata Aeronautike e Kosovës

Neni 6.

Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj rregulloreje bëhen në mënyre dhe procedurë të njejtë sikur me rastin e miratimit të saj, pra ndryshimet propozohen nga komisioni për paragllajdzëm në kuadër të FAK si dhe dëgohen për votim në kryesinë e FAK.

Neni 7.

Rregullorja hyn në fuqi ditën e miratimit.

Prishtinë, 04.03.2015

Kryetari i FAK
Fadil Gërguri

Kryetari i komisionit për paragllajdzëm
Ardall Celina